

VENDIM
Nr. 723, datë 16.9.2020

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 236, DATË 30.3.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA
ZBATIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI, RIKONSTRUKSIONI DHE RINOVIMI I
UNAZËS SË VOGËL, LOTI 3”, TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 236, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Tabelës me listën e pronarëve dhe të pasurive që preken nga projekti “Ndërtimi, rikonstruksioni dhe rinovimi i Unazës së Vogël, loti 3”, i bëhen shtesa dhe ndryshime sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Në pikat 3 dhe 4, vlerës së përgjithshme të shpronësimit i shtohet vlera prej 17 948 901 (shtatëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e një) lekësh, e cila do të përballohet nga Bashkia Tiranë.

3. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**LISTA E PASURIVE QË SAKTËSOHEN TË PREKURA NGA PROJEKTI “PËR NDËRTIMIN, RIKONSTRUKSIONIN DHE RINOVIMIN E UNAZËS SË VOGËL”,
(LOTI 3), TIRANË**

Sipas VKM-së nr. 236, datë 30.3.2016													Saktësimet e VKM-së nr. 236, datë 30.3.2016											Shënime
Të dhënat ishin													Të dhënat bëhen											
Nr.	NR.	Nr. rend në VKM	Emër Mbiemër	ZK	Nr. i pas.	Sipërf. e përgj. truallit, m ²	Sipërf. truallit i prekur, m ²	Çmimi i truallit lekë/m ²	Sipërf. e përgj. objekt m ²	Sipërf. e prekur obj., m ²	Çmimi obj. lekë/m ²	Vlera truall + objekt në lekë	Emër Mbiemër	Nr. pas.	Sipërf. e përgj. truallit m ²	Sipërf. truallit i prekur m ²	Çmimi i truallit lek/m ²	Sipërf. e përgj. objekt m ²	Sipërf. e objektit të prekur m ²	Çmimi i obj. lek/m ²	Vlera truall + objekt në lek	Lloji i dokumentit		
1	1	10	SHTET	8360	7/147	226	226	66969	120	120	0	0	Zamira Abdurrahman Sykja	7/147	82.01	82.01	66969	57.58	57.58	101602	9414333	Shkr. e ZVRPP-së nr. prot. 7137/1, datë 4.5.17	Masë konservative	
2	2	37	Bashkëpr. Vaqari.	8360	7/149	27.56	5	66969	27.56	5	101602	842855	Bashkëpr. Vaqari, Kujxhiu, Toska.	7/149	28	5	66969	28	28	101602	3179701	Shkr. e ZVRPP-së nr. prot. 7137/1, datë 4.05.17	Te përshkrimi i veçantë: 309 m ² objekt.	
3	3	28	Mehmet Muharrem Këllezi	8360	6/188-ND	0	0	66969	168	168	101602	17069136	Bashkëpr. Këllezi, Dashi, Durda, Hallulli, Vathi, Fortuzi, Daka, Pulaj, Pilinci, Shijaku, Pëllumbi, Brahimasi, Skënderaga, Shima, Koçibelli dhe Bodinaku.	6/188-ND	0	0	66969	309	309	101602	31395018	Shkr. e ZVRPP-së nr. prot. 7137/1, datë 4.5.17		
4	4	30	Dorian, Fatmir Dobrolishti	8360	6/189 / ND+1 -2/1	0	0	66969	100	100	101602	10160200	Dorian, Fatmir Dobrolishti	6/189 / ND+1 -2/1	0	0	66969	20	20	101602	2032040	Shkr. e ZVRPP-së nr. prot. 7137/1, datë 4.5.17		
Shuma												28072191	Shuma										46021092	

Shënime:

- Për truallin, çmimi i illogaritur është marrë nga VKM-ja 89, datë 3.2.2016.
- Pasuritë e saktësuara konfirmohen nga ZVRPP-ja, Tiranë, me shkresën nr. prot. 7137/1, datë 4.5.2017.
- Objektet janë rillogaritur sipas mesatares së shitjeve nga ZVRPP, Tiranë, me shkr. nr. prot. 29694/6, datë 29.1.2016 dhe me shkr. nr. prot. 4301/1, datë 24.2.2016.
- Tab. e ndryshuar vetëm për pasuritë nr. 7/147, nr. 7/149, nr. 6/188 ND dhe nr. 6/189 ND +1-2/1.
- Pasuria 6/188 - ND, konfirmuar nga ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. prot. 7137/1, datë 4.5.2017, sip. e përgjith. e ka 309 m² (ND me 2 kate), që duhet të shlyhet totalisht.
- Pasuria nr. 7/147, konfirmuar nga ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. prot. 7137/1, datë 4.5.2017, sipas VKM-së nr. 236 ka qenë shtet, për pasurinë nr. 7/147 është lëshuar certifikatë pronësie për 82,01 truall dhe objekt është 28.79 m², me 2 kate, sipas përshkrimit të veçantë të kartelës së pasurisë. Sipërfaqes së truallit i zbritet sip. e ndërtësës mbi të. Janë bërë ndryshimet në tabelë, për sa i përket vlerës së shpronësimit.
- Pasuria 6/189 - ND+1-2/1, konfirmuar nga ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. prot. 7137/1, datë 4.5.2017, sip. e përgjith. është 20 m², e cila ka qenë 100 m² nuk është shlyer sipas VKM-së nr. 236 dhe duhet të shlyhet për 20 m².
- Pasuria 7/149, konfirmuar nga ZVRPP Tiranë, me shkresën nr. prot. 7137/1, datë 4.5.2017, sip. e përgjith. e ka 28 m² (tr.+ND 1 kat), nga të cilat 5 m² janë prekur sipas projektit, e cila gjatë ndërhyrjes është prishur e gjitha për arsye të mosqëndrueshmërisë. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, me shkresën nr. prot. 17518, datë 8.6.2016, bën me dije se objekti nuk qëndroi nga ana konstruktive.